URDHËR
Nr. 110, datë 22.1.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 28 dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të pikës 5, të nenit 11, shkronjës "o", të nenit 12, të Statutit të DPSHTRRsë,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave administrative të drejtorit të përgjithshëm të DPSHTRR-së zëvendësdrejtorit të përgjithshëm, z. Endri Haxhiu, për nënshkrimin e akteve administrative në formën e vendimeve, certifikatave, licencave dhe trajtimin, komunikimin, ndjekjen e procedurave zyrtare, objekt të veprimtarisë së Drejtorisë së Licencimit dhe Certifikimit.
2. Delegimin e kompetencave për trajtimin, komunikimin, ndjekjen e procedurave zyrtare në çështjet kryesisht të karakterit teknik dhe rregullator të institucionit, si dhe nënshkrimit e kërkesave për informacion të dërguara zyrtarisht nga institucione shtetërore, persona fizikë dhe juridikë, shqiptarë dhe/ose të huaj.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet dhe mban përgjegjësi zëvendësdrejtori i përgjithshëm, z. Endri Haxhiu dhe asistenti i kabinetit në DPSHTRR.
4. Delegimi i kompetencave fillon më datë 22.1.2024.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ilir Mëngra